



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.84/2024

Prishtinë, më 08.04.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Arjeta Fejza, Albana Bytyçi, Drita Millaku, Nasuf Bejta, Fatmire Kollçaku, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Munguan: Labinotë Demi- Murtezi dhe Ariana Musliu- Shoshi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Genti Ramosaj – GP AAK, Hysni Mehani - GP LVV, Marigona Pajaziti – GP PDK, dhe Besim Haliti – Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të fundit;
3. Shqyrtimi i Projektrezolutës për vlerësimin e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i peticioneve;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të fundit

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datë 6,13 dhe 21 shkurt 2024.

3. Shqyrtimi i Projektrezolutës për vlerësimin e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022

Kryetarja, tha se kemi në shqyrtim Projektrezolutën për vlerësimin e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022. Me Rregulloren e re të Kuvendit, Komisioni duhet ta shqyrtojë dhe ta miratojë një raport mbi vlerësimin e punës së IAP-it.

Arjeta Fejza, tha se jo të gjithë kanë mbërritur t'i lexojnë dhe t'i analizojnë materialet, për arsye se u diskutuan para fillimit të mbledhjes.

Ajo shtoi se është mirë të lexohen pikat nen për nen dhe të shqyrtohen, sepse procedohet si miratim i Komisionit dhe kemi për të mbajtur përgjegjësi.

Ky quhet raporti i punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, por këtu brenda përfshin edhe qëndrime të Komisionit, që në fakt nuk kanë të bëjnë me punën e Avokatit të Popullit, ose mund të jenë çështje që i ka trajtuar IAP, por jepet si qëndrim i Komisionit, p.sh. thuhet se Komisioni Funkcional i konsideron të arsyeshme shqetësimet e ngritura në raport, lidhur me çështjen e trajtimit të rasteve të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Këto shqetësime kanë të bëjnë me: zvarritjen dhe tejkalimin e afateve të përcaktuara për shqyrtimin e aplikacioneve, deri te marrja e vendimit, rishqyrtimi i kërkesave dhe trajtimi i ankesave nga po i njëjti Komision, vendimet shpeshherë jo përmbajtjesore dhe të paqarta, arsyetimet e ngjashme për raste të ndryshme, vështirësitë gjatë intervistimit, për shkak të gjendjes së tyre emocionale, zvarritja e procesit në gjykatë dhe mos-shqyrtimi meritor i rasteve.

Komisioni Funkcional mbështet qëndrimin e organizatave joqeveritare të autorizuara për mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në procesin e aplikimit, lidhur me heqjen e kufizimit ligjor të afatit kohor për aplikim.

Lidhur me këto, tha se ne si Komision e kemi mbështetur shtyrjen, e kemi votuar edhe në seancë, por heqja është diçka tjetër. Kërkesë e tyre ka qenë heqja, por ne e kemi bërë shtyrjen dhe kjo nuk përkon me atë se çka kemi punuar ne.

Eliza Hoxha, tha se heqja e afatit për aplikim të statusit për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, ka qenë kërkesë e OJQ-ve, mund të jetë kërkesë edhe Avokatit të Popullit, direkt, por nëse në Kuvend është votuar shtyrja e afatit, nuk duhet të figurojë në raport se çka kemi punuar ne, sepse në raport ai ka përfshirë vetëm punët që i ka bërë IAP.

Tha se është mirë të bëhen komentet, lidhur me këtë rezolutë dhe me komentet që do t'i paraqesin, të bëhet një dokument i përditësuar, që procedohet nga Komisioni dhe t'i dërgohet edhe Avokatit të Popullit.

Kryetarja deklaroi se po mbetet që të paraqesin komentet me shkrim, përmes emailit dhe pastaj të kompletohet ky dokument.

Marigona Geci, tha se ato që janë paraqitur në këtë draft-rezolutë, si të Komisionit, duhet të hiqen, sepse këtu po flitet për punën e Avokatit të Popullit.

4. Shqyrtimi i peticioneve

Kryetarja, tha se peticionet i kanë pranuar me kohë. Si komision, kemi një peticion të mjekëve specialistë të nivelit sekondar dhe terciar, të sistemit publik shëndetësor. Ky peticion përmban diku 360 nënshkrime.

Grupi i mjekëve, në këtë peticion, kanë shprehur shqetësimin pas hyrjes në fuqi të Ligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, i cili është miratuar në korrik të vitit 2022.

Në peticion, mjekët nënshkruar e konsiderojnë diskriminuese paragrafin 1 të nenit 5 të ligjit të lartpërmendur, për shkak se, siç thonë ata, i vë në trajtim jo të barabartë me kolegët tjerë të profesionit të njëjtë, të cilët janë të punësuar në nivelin parësor dhe të cilët nuk obligohen për deklarin e pasurisë.

Pra, kërkesa e këtij grupi të mjekëve është ndryshimi i dispozitës së nenit 5, paragrafi 1 dhe nën- paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.

Sipas informatave, i njëjti peticion i është dërguar edhe Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Eliza Hoxha, tha se është diskriminuese, sepse nëse duhet deklarin pasurinë, duhet të jetë për të gjithë mjekët ose për asnjë mjek të atij lëmi.

Fatmire Kollçaku, tha se përfaqësuesit e këtij peticioni, së pari kanë vënë theksin tek elementi i diskriminimit, në raport me kolegët që punojnë në kujdes parësor shëndetësor. Çështja e dytë, është se konsiderojnë denigruese dhe të papranueshme deklarin, sidomos publikimin e të dhënave.

Kjo është e rregulluar me ligj, por këta nuk e kanë adresuar vetëm kuptimin padrejtësi për të gjithë mjekët dhe të merren me kategoritë e veta. Pra, nuk po i adresojnë kërkesat e veta, por po i adresohen një kategorie që nuk është e përfshirë. Nëse është qëllimi të bëjnë edhe mjekët e kujdesit parësor deklarin e pasurisë, që të bëhet një amendament i ri në ligj, kjo po del në një shteg tjetër në këtë problem dhe nuk po e kuptoj cila është kërkesa kyçe.

Eliza Hoxha, tha se këtu flitet për diskriminim se deklarin e pasurisë duhet ta bëjnë vetëm ata që janë nëpër pozita menaxheriale. Këtu po flitet për dikë që kanë profesionin e njëjtë dhe dikush deklaron pasurinë e dikush nuk e deklaron pasurinë.

Arjeta Fejza, tha se i është drejtuar Komisionit për Legjislacion, pasi ky ligj ka kaluar nëpër atë Komision dhe është interesuar se si ka qenë debati kur është shqyrtuar ligji aty, sepse i ka interesuar te pjesa e profesorëve, pasi që ajo është pjesë e Komisionit për Arsimit. Profesorët e nivelit parauniversitarë nuk e bëjnë deklarin e pasurisë, është i përfshirë vetëm niveli i profesorëve universitarë, për shkak të argumentit se ata angazhohen edhe në institucione private dhe kanë variacion të të hyrave. Këta është dashur të sjellin argumentet për kategorinë e vet e jo të penalizojnë kategoritë tjera.

Eliza Hoxha, propozoi që lënda të adresohet tek Avokati i Popullit, meqë po bëhet fjalë për diskriminim, le ta shqyrtojnë këtë peticion, dhe si institucion i pavarur, le të japë mendimin e vet.

Kryetarja konstatoi se Komisioni vendosi që këtë peticion ta adresojë për shqyrtim në IAP.

Kryetarja, më tutje, tha se kemi edhe një peticionin nga Drita Gjonbalaj, zyrtare e prokurimit në AKP, e nënshkruar nga gjithsej 23 zyrtare të tjera, të kësaj agjencie.

Kërkesa nga ky peticion ka të bëjë me avancimin në pozita menaxheriale për kandidatet e gjinisë femërore dhe respektimin e Ligjit për barazi gjinore, lidhur me kuotën gjinore 50% për pozitat drejtuese dhe vendimmarrëse në AKP.

Drita Gjonbalaj, kundër AKP-së, ka paraqitur ankesë edhe në IAP, lidhur me çështjen e lartpërmendur dhe IAP ka nxjerrë një letër-rekomandim ndaj ankesës së saj, ku i ka rekomanduar AKP-së, të zbatojë obligimin ligjor të përcaktuar në Ligjin për barazi gjinore.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, lidhur me këtë peticion, vendosi që të ftohen në takim, më datë 16 prill 2024, Drita Gjonbalaj dhe disa përfaqësuese të këtij peticioni.

5. Të ndryshme

Arjeta Fejza, tha se kur ishte takimi me organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ishte një kërkesë e znj. Feride Rushiti, nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), që kishte të bënte me çështjen e rritjes së numrit të prokurorëve, që do të merren me krime të luftës dhe krime të dhunës seksuale në Kosovë.

Ajo na pati njoftuar se vetëm tre prokurorë merren me rastet e dhunës seksuale, 9 prokurorë janë që merren me krimet e luftës. Në vijim, tha se janë shumë të shqetësuar, sepse janë duke vdekur gratë, dhe së bashku me to, janë duke vdekur edhe motivet e tyre e që nuk po ka inicim të rasteve. Kjo veçmas në rastet kur gratë e denonconin me emër dhe mbiemër dhunuesin.

Në takimin e lartpërmendur u kërkua nga Komisioni, që nëse ka mundësi, të organizohet një takim me përfaqësues të KPK-së, ku do të ishte e ftuar edhe ministrja e Drejtësisë.

Fatmire Kollçaku, tha se ka kuptuar që për qendrat për punë sociale, nga ana e gjyqësorit kanë vërejte se ka joprofesionalizëm dhe direkt ndikon në fatin e fëmijëve dhe kërkoi të bëhet një takim edhe për këtë çështje.

Kryetarja konstatoi se Komisioni vendosi të ftojë në takim, më datë 16 prill 2024, kryesuesin e Këshillin Prokurorial, lidhur me çështja e rritjes së numrit të prokurorëve, që do të merren me krime të luftës dhe të dhunës seksuale në Kosovë.

Nëse nuk mund të përgjigjen me këtë datë, KPK le të propozojë një datë lidhur me mbajtjen e takimit, theksoi ajo.

Kryetarja ngriti çështjen e peticionit të Sindikatës së Policisë dhe pyeti se si mund të japim një përfundim, si Komision, pasi që kemi shkruar disa herë në adresë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, por nuk kemi asnjë përgjigje, ndërsa Sindikata e Policisë po pret përgjigje nga ne.

Eliza Hoxha, tha se duhet ngritur çështjen me ligjin, i cili i obligon institucionet të përgjigjen në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Fatmire Kollçaku, tha se secila ministri duhet ta ketë zyrën që merret me adresimet e qytetarëve. Lidhur me këtë, pyeti: Sa herë i është dërguar ftesë për pjesëmarrje në Komision, ministrin të Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla?

Kryetarja, tha se për ministrin Sveçla, kanë dërguar ftesë tri herë.

Fatmire Kollçaku, tha se është në dijeni se Ministria e Punëve të Brendshme kanë lëvizur pozitivisht në realizimin e disa kërkesave të Sindikatës, por nuk po na i dërgojnë neve njoftimet dhe kërkoi kohë nga Komisioni. Po ashtu, tha se do të bëjnë përpjeke, që të kontaktojnë me ministrin.

Kryetarja, tha se meqë deputetët nga radha e LVV-së janë me të afërt me ministrin, le të kontaktojnë dhe të na njoftojnë javën tjetër, nëse ministri do të vijë në Komision.

Nasuf Bejta, tha se ministrat, ligjërisht e kanë obligim të vijnë dhe të përgjigjen, nëse ministri nuk ka kohë të vijë në Komision, ai ka zëvendës dhe le ta dërgojë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda BALJE,
Kryetare e Komisionit